



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 32, datë 22.04.2022

PËR

AKREDITIMIN E PARË TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
BACHELOR NË “MATEMATIKË”, TË UNIVERSITETIT “ISMAIL QEMALI”, VLORË

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 11.9.2018, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr.1, datë 07.04.2017, “Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit” dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 22.04.2022, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në “**Matematikë**”, me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Bachelor në “**Matematikë**”
- b) Cikli i studimit: Cikli i parë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 832, datë 04.06.2008
- d) Institucioni që e ofron: Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë
- e) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Matematikës
- f) Kohëzgjatja (Vite/ semestra): 3 vite/6 semestra
- g) Kredite (ECTS): 180 kredite
- h) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- i) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë
- j) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 6

pasi **mori në shqyrtim:**

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Raportimin e Ekspertëve të Vlerësimit në mbledhjen e Bordit;
- e. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- f. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- g. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuar e verifikuar përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësimin të *“Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”* dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit është **“i përmbush kryesisht standardet”**, me mangësitë si më poshtë:
 1. Mungesa e një studimi të mirëfilltë të tregut të punës dhe strategjisë së punësimit për studentët të cilët diplomohen në këtë program studimi.
 2. Numër i ulët i orëve laboratorike në planin mësimor të këtij programi studimi, sidomos në lëndët *Probabilitet-Statistikë* dhe *Analizë Numerike*, të cilat zhvillohen nëpërmjet *software*-ve kompjuterike.
 3. Realizimi pa sekretim ose kodifikim i provimeve, për studentët e këtij programi studimi.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,

VENDOSI:

1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit **Bachelor** në **“Matematikë”**, të **Universitetit “Ismail Qemali”**, Vlorë, me rekomandimet sipas shtojcës së këtij vendimi.
2. **Akreditimin** e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **4 (katër)** vite.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **21/04/2026**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij

vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT

SHQIPONJA TELHAJ		Kryetare
ALEXANDER KOHLER		Anëtar
AYŞEN SAVAŞ SARGIN		Anëtar
TOMASZ JELENSKI		Anëtar
IRAJ HASHI		Anëtar
MAURICE OUDEJANS		Anëtar
LEA YPI		Anëtar
KITA SALLABANDA DIAZ		Anëtar
DARINKA PIQANI		Anëtar
DRITAN NAÇE		Anëtar

INDRIT HOXHA

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Indrit Hoxha', with a horizontal line underneath.

Anëtar

Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 32, datë 22.04.2022, “Për akreditimin e parë të programit të studimit **Bachelor** në “**Matematikë**”, të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, janë si vijon:

1. Institucioni, të hartojë një plan masash me qëllim rritjen e interesit dhe numrit të studentëve për këtë program studimi, si:
 - hartimi i një studimi të mirëfilltë të tregut të punës;
 - zhvillimi i fushatave promovuese për nxitjen e maturantëve të rajonit të Vlorës për të studiuar në këtë program studimi;
 - mbështetje të vazhdueshme për departamentin përgjegjës për realizimin e këtij programi studimi.
2. Institucioni, të rishikojë planin mësimor të këtij programi studimi, me qëllim shtimin e orëve laboratorike sidomos në lëndët *Probabilitet-Statistikë* dhe *Analizë Numerike*, të cilat zhvillohen nëpërmjet *software-ve* kompjuterike.
3. Institucioni, të marrë masa që provimet e studentëve të këtij programi studimi, të zhvillohen me sekretim ose kodifikim.
4. Institucioni, të rrisë gamën e metodave dhe instrumentave që përdoren në kuadër të vlerësimit e sigurimit të cilësisë në këtë program studimi, sidomos në marrjen e mendimit të studentëve dhe dëgjimin e zërit të tyre.
5. Institucioni, të shohë mundësinë e përfshirjes në kurrikulën e këtij programi studimi, të lëndëve me karakter ekonomik, me qëllim që studentëve tu krijohet mundësia e diversifikimit të studimeve në ciklin e dytë.
6. Institucioni, në zbatim të Udhëzuesit mbi Zhvillimin dhe Përdorimin e Metodave të Ndryshme dhe Inovative të Mësimdhënies në Bazë të Fushës së Studimit, të thellojë kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e kërkimor shkencor, të angazhuar në këtë program studimi.

Në përmbushje të rekomandimeve të mësipërme, **Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë**, duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret dhe ta dorëzojë atë brenda 6 (gjashtë) muajve pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

